



SEKTORI SOCIAL

Raport Janar – Maj 2009

Projektet e sektorit Social te Caritas-it Shqiptar qe zhvillojne aktivitetet ne periudhen Janar – Maj 2009 jane:

- Projekti: “ Formimi i animatoreve”
- Projekti: “Animacioni Social me grupet e grave”
- Projekti: “Edukimi informal për zhvillimin qytetar te te rinjeve ”
- Projekti per studimin e problemit te gjakmarrjes
- Aktivitetet e grupit te Vullnetareve te Caritas Shqiptar.
- Projekti i Bashkepunimit Rajonal PSM
- DAP ALBANIA

PROJEKTI I FORMIMIT TE ANIMATOREVE

Ky projekt ka filluar ne vitin 1999 dhe vazhdon edhe ne 2009. Gjate zbatimit 10 vjecar te ketij projekti ndryshimet dhe permisimet e tij kane qene sistematike. Fakti qe kerkesat nga qendrat e ndryshme te Caritas-it Shqiptar jane te vazhdueshme, tregon se sa i rendesishem eshte formimi i te rinjeve. Formimi i te rinjeve edhe pse ka si qellim dhenien e njohurive dhe teknikave ne fushen e animacionit, se pari eshte nje ecje ne formimin human te te rinjeve.

Ne muajin Janar stafi i sektorit social ka perzgjedhur qendrat ne te cilat do zhvillohen formimet dhe aktivitetet e projektit. Ekipi i formatoreve nen kujdesjen edhe te Drejtorit te Caritas-it Shqiptar jane perpjekur qe te asistojne sa me shume qendra.

Formimet e animatoreve ne strukturen e tyre perbehen prej 3 fundjavash, ne te cilen bashkohen te rinjte e disa qendrave. Formimet e zhvilluara deri tani jane :

- Formimi ne Qendren Shen Avlash me pjesmarrjen e 35 te rinjeve : Shen Avlash, Kruje dhe Derven.
- Formimi ne Famulline Elbasan me pjesmarrjen e 30 te rinjeve.
- Formimi ne Shkoder me pjesmarrjen e 33 te rinjeve: Bardhaj, Dajc- Bregu Bunes, Fermentim, Bajze, Velipoje, Trush dhe Rranza.
- Formimi ne Delvine me pjesmarrjen e 25 te rinjeve.
- Formimi ne Lushnje me pjesmarrjen e 40 te rinjeve: Lushnje, Plug, Bubullime dhe Karbunar.

Formimet do te vazhdojne dhe pritet qe ne fund te zhvillohet edhe nje kamp formimi ne bashkpunim me projektin e “Edukimi Qytetar i te rinjeve”. Ekipi i formimit do te rifilloje formimet ne muajin Shtator 2009.

Ekipi i formatoreve te Caritas Shqiptar eshte gjithashtu ne pregatitje per te ndihmuar qendrat per aktivitetet verore. Sikurse dihet qendrat e ndryshme aktivitetet intensifikohen ne periudhen Korrik – Qershor. Per kete arsye ekipi i formatoreve ka planifikuar vizitat e shoqerimit ne qendra per te programuar zhvillimin e kampeve, si dhe pregatitjen e materialeve didaktike.

PROJEKTI I ANIMACIONIT SOCIAL

Ky projekt vazhdon te zhvillohet ne 4 zona: Lac, Balldren, Bathore dhe Gostim. Ne te kater zonat jane zhvilluar takime te ndryshme me grupet e grave te konsoliduara tashme.

Aktivitetet e ketij viti kane filluar me vleresimin e vitit 2008. Ne takimet e organizuara ne te kater zonat kane marre pjese 25 – 30 gra nder to edhe lideret e grupit, animatorja e zones, pergjegjes te qendrave si dhe koordinatorja e programit. Keto takime kane qene shume efektive pasi te gjithe aktoret e ketij programi vune ne dukje punen e bere, veshtiresit e hasura, dhe pikat e dobeta.

Animatorët e cdo zone vazhdojne takimet javore me grupet e grave si dhe diskutimet per problematika te ndryshme. Ne te kater zonat zhvillohen takime formuese me grupet e grave per tema si: Mardheniet prind – femije, mardheniet me adoleshentet, familja etj.

Nje aktivitet i rendesishem eshte mbeshetja e iniciativave te ndryshme te grupeve te grave per permisimin e jeteses se tyre ne komunitet. Keto iniciativa jane me natyra te ndryshme si:

- Ne Balldren Grupi i grave kane vleresuar si te rendesishem permisimin e kushteve te edukimit te femijeve ne shkollen fillore. Ne kete shkolle mungon uji dhe kjo gje ka sjelle probleme per femijet. Iniciativa e grave ka patur si qellim hapjen e pusit, vendosjen e pompes se ujit e cila do te beje funksionale edhe tualetet e shkolles. Realizimi i kesaj iniciative u be e mundur nepermjet bashkpunimit te disa aktoreve si: Caritas Shqiptar, Famulltari i zones, drejtorja e shkolles si dhe komuniteti.
- Ne Gostim iniciativa ka qene me shume e karakterit formues. Grupi i grave ka vleresuar si te rendesishem formimin e tyre profesional. Ne Gostim eshte zhvilluar nje kurs guzhine. Ky kurs ka qene i rendesishem jo vetem per marrjen e disa njohurive por edhe per te diskutuar rreth ceshtjeve te ndryshme.
- Ne Lac para konviktit ishte krijuar nje situatë ambjentale shume serioze. Para konviktit kanali ishte i mbuluar nga mbeturinat te cilat shkaktonin ndotjen e ajrit, ererat e keqija e per me shume semundje te femijet. Sensibilizim i banoreve nepermjet animacionit si dhe perfshirja e femijeve ishte nje aktivitet i rendesishem. Gjithashtu pastrimi i ketij kanali nga banoret, largimi i mbeturinave ne bashkepunim dhe me zyrën e komunales se qytetit solli nje impakt te mire ne komunitet dhe shpresohet qe te mos keqperdoret ne te ardhmen.
- Ne Bathore ka nje dinamike interesante pasi Grupi i grave jane me prane famullise. Tashme kane filluar 2 kurse: Rrobaqepesi dhe Kuzhine ne te cilen marrin pjese 15 gra nga lagja e stallave.
- Ne Gostim grate jane aktive dhe bashkpunojne shume me animatoren dhe Murgeshat e zones. Ato kane pregatitur gjate muajit shkurt listen e familjeve me te varfere te cilat kane nevoje per ndihme : ekonomike, mjeksore .

Ne muajin Maj do te zhvillohet dhe takimi nder –grupor ne Balldren. Ne kete takim do te marrin pjese perfaqesueset e te 4 grupeve. Keto takime sherbejne per te shkëmbyer eksperience ndermjet grupeve si dhe per te folur rreth aktiviteteve ne vazhdim. Ne te 4 grupet vihet re roli i rendesishem i liderve.

Nje fakt shume i rendesishem ne kete projekt eshte dhe ndihma individuale qe japin animatorët e zonave per familjet me probleme ose ne varferi ekstreme. Animatorja e Gostimes ndihmon vecanerisht familjet me person me aftesi te kufizuar. Ajo ndihmon ata ne pregatitjen e dokumentave per te dalur ne Kemp si dhe i shoqeron ata kur dalin para komisionit mjekesor. Ne Bathore animatorja ndihmon familjet e varfere me femije te semure per tu dhene informacion rreth rimbursimit te ilaceve ose i ndihmon ne gjetjen e ilaceve ne bashkpunim me sektorin shendetesor.

PROJEKTI PER EDUKIMIN QYTETAR TE TE RINJEVE

Objektivi i ketij projekti eshte: **“Te rinjte dhe femijet jane te afte te jetojne nje jete me te mire ne bazen e normave dhe vlerave sociale te pranuar”**

Ky projekt ka marre tashme ritmin e tij intesiv te aktiviteteve. Muaji janar ka qene muaji ku jane percaktuar trajnimet qe do te zhvillohen ne te 4 zonat te cilat zhvillohet projekti. Vazhdojne aktivitetet ne cdo zone ku koordinatoret dioqezan jane ne kontakt te vazhdueshem me qendrat. Koordinatoret dioqezan shoqerone te rinjte e qendrave per zhvillimin e aktiviteteve.

Ekipi i Caritas-it Shqiptar zhvillon takime formuese me te rinjte e qendrave te cilat kerkojne nje asistenc teknike per shkrimin e mini projekteve apo per fenomene te ndryshme sociale.

Projekti zhvillohet ne 6 faza.

Faza e pare: Perzgjedhja e stafit qe do te implementoje projektin.

Faza e dyte: Mbledhja e te dhenave ne qendra te ndryshme per cdo dioqeze.

Faza e trete: Zhvillimi i aktiviteteve formuese, animuese dhe sportive ne qendra me te rinjte dhe femijet.

Faza e katert: Prezantimi i propozimeve per miniprojekte nga cdo dioqeze.

Faza e peste: Miratimi dhe realizimi i miniprojekteve.

Faza e gjashte: Raportimi dhe Vleresimi i projektit.

Ne muajin Shkurt Caritas-i Shqiptar hapi Shpalljen per mini projekte. Mini projektet qe do te financohen nga ky projekt kane kryesisht si objektiv te tyre aktivitetet me femijet dhe te rinjte. Projektet e miratuara nga kjo shpallje e pare jane financuar miniprojektet:

DIOQEZA JUG

Fitues 7 mini projekte:

Fier: Pashket, Ringjallja e Krishtit Mbret

Babice: Historia e Moisiut

Gostime: Ambasadoret e Shpreses nje Inisiative Model ne Komunitetin e Zones

Delvine: Edukim per Zhvillimin e te Rinjve.

Pus Mezini: Sjellja e Edukuar – Deshire apo Realitet

Orikumi: Projekt per Aktivitete Sportive dhe Krijuese per Femijet dhe te Rinjte.

Elbasani: Aktivitetet Sportive me Femijet dhe te Rinjte

DIOQEZA TIRANE-DURRES

Fitues 4 mini projekte:

Laç : Femijet me Aftesi te Kufizuar Jane Si Ne.

Vullnetaret e Caritas-it: Vullnetarizmi nje Vlere per te Rinjte.

Qendra sociale ‘Don Bosko’: Shtepia e Miqve-Me Shume Mundesi per Personat me Aftesi te Kufizuar

Vullnetaret e Caritas-it : Animojme se Bashku.

DIOQEZA SHKODER-PULT

Fitues 6 mini projekte:

Famullia Koplik: Formimi Njerezor i te Rinjve

Qendra “Bariu I Mire”- Fermentim: Animacion me Femijet dhe te Rinjte

Qendra “Don Orione”- Bardhaj: “Paulus”=Pali

Qendra Sociale “Don Bosko” : Te orientojme te rinjte ne boten e punes.

Famullia Dajc Bregu I Bunes: Rinia urgjence qe kerkon vemendje.

Komisioni Dioqezian Per Rinine: Dita Boterore e Rinise ne Dioqezan Shkoder-Pult

Nen kujdesin e Drejtorit te Caritas-it Shqiptar u financua edhe nje mini projekt i paraqitur nga “Ambasadoret e Paqes” – ISHULLI I PAQES.

Ne muajin Qershor do te hapet Shpallja e II per financimin e miniprojekteve. Kjo Shpallje e dyte synon mbeshtetjen e qendrave per aktivitetet e periudhes Korrik – Gusht e cila eshte edhe me shume aktivitate.

PROJEKTI PER STUDIMIN E PROBLEMIT TE GJAKMARRJES

Ne muajin Janar 2009 ka filluar nje pune interesante dhe intensive ne projektin per Studimin e problemit te Gjakmarrjes, nje projekt qe po zhvillohet se bashku me Komisionin Drejtesi dhe Paqe. Koordinator i projektit ka percaktuar fushat ne te cilat do te perqendrohet per mbledhjen e te dhenave te studimit si: Fokus grupet, Jurist, Prokurori, Media.

Kane filluar plotesimet e ketyre pyetesoreve ne disa zona si: Tirana, Fieri, Elbasani dhe Vlora. Per kete koordinatori po bashkepunon me ekipin e formatoreve.

Koordinatori ka zhvilluar intervista me: juriste si dhe me nje prokuror.

Gjithashtu jane zhvilluar disa fokus grupe per mbledhjen e informacionit dhe opinionit te kategorive te ndryshme te shoqerise rreth “ Gjakmarrjes”.

Koordinatori i projektit ka bere nje vizite dhe ne Blinisht prane “Ambasadoreve te Paqes” per te folur, diskutuar dhe marre informacion bazuar ne punen e tyre.

Nje aktivitet i rendesishem ne kete projekt eshte edhe ai qe ka si qellim monitorimin e shtypit. Ky aktivitet do te studjoje se sa vemendje i kane kushtuar mediat shqiptare fenomenit te Gjakmarrjes. Kjo po zhvillohet ne 3 drejtime:

- Monitorimi i edicioneve kryesore te lajmeve.
- Bashkpunimi me dy televizione: TVSH dhe Alsat, per te vleresuar vemendjen e ketyre televizioneve rreth ketij fenomeni. Per kete arsye po shihen arshivat e te dy ketyre televizioneve per te bere nje vleresim konkret.
- Intervistat me gazetaret te cilet kane zhvilluar emisione apo kronika rreth fenomenit.

Nje aktivitet qe do te zhvillohet ne muajin Maj eshte intervistimi i disa prej Sociologeve dhe Psikologeve. Keto intervista pritet qe te japin nje informacion te kenaqshem rreth ceshtjeve te ndryshme qe lidhen me kete fenomen.

Nje pike e rendesishme e ketij projekti eshte edhe perpunimi statistikor i te dhenave te mbledhura nga pyetesoret. Rezultatet e ketij sondazhi do te paraqiten edhe ne raportin perfundimtar.

Vazhdojne takimet ndermjet Koordinatorit te Caritas-it Shqiptar dhe Koordinatorit te Komisionit Drejtesi dhe Paqe. Keto takime kane si qellimi vleresimin e aktiviteteve te zhvilluara si dhe parashikimin e aktiviteteve ne vazhdim.

AKTIVITETET E GRUPIT TE VULLNETAREVE TE CARITAS SHOIPETAR

Grupi i vullnetareve te Caritas-it Shqiptar perbehet prej rreth 40 animatoresh te rinj. Keta te rinje jane kryesisht animatore qe i bashkojne motive per te promovuar figuren e animatorit nepermjet veprimtarive te ndryshme vullnetareve. Motivimi i ketyre te rinjeve nuk eshte thjesht animacioni por edhe nje motivim human per ti qendruar prane grupeve ne nevoje. Keta te rinje nuk jane thjeshte nje grupim njerezish por nje shoqeri e cila promovon nepermjet angazhimeve te tyre punen vullnetare ne realitetin Shqiptar.

Grupi i vullnetareve te Caritasit Shqiptar vazhdon aktivitetet :

Ne spitalin Pediatrik te Tiranes. Qellimi kryesor i punes se grupit te vullnetareve eshte argetimi i femijeve me leucemi permes aktiviteve kreative animuese, lojrave teater, lojrave me kukulla etj si dhe lehtesimin e kushteve psikologjike. Drejtoria e spitalit ka vene ne dispozicion nje dhome per vullnetaret e Caritas-it ku ata mund te pergatisin dhe te zhvillojne aktivitetet. Keto aktivite zhvillohen vetem njehere ne jave, te dielave sepse gjate javes femijet kane nevoje per trajtim mjekesor pa shkeputje.

Arsyeja e kesaj nderhyrjeje sepse ne spitale mungojne strukturat institucionale per te ofruar keto sherbime per te femijet.

Ne Azilin e Motrave te Nene Terezese: grupi i vullnetareve te Caritas-it Shqiptar eshte ne kete qender qe nga fillimi i vitit 2007, nje here ne jave (zakonisht te Dielave) ata ndihmojne motrat ne:

Kujdesin shendetesor ndaj te moshuarve

Kujdesin personal (Higjenen) ndaj te moshuarve.

Mirmbajtjen e ambjenteve, gatimin, pastrimin etj

Argetimit permes aktiviteve te ndryshme per njerezit e strehuar ne kete azil.

Ne burgje: Grupi i vullnetareve te Caritasit Shqiptar filloi punen ne Shtator 2008 duke organizuar animacione, sport, dhe aktivite kreative kryesisht ne burgun 325 ne Tirane . Ne Janar 2009 Drejtori i Caritas-it Shqiptar vendosi qe puna me kete kategori personash te jete edhe me e perhapur. Ne bashkpunim me pergjegjesin e baritores se të burgosurve nje grup vullnetarësh shkon edhe ne burgun e Krujes dhe ne te ardhmen pritet te perfshihen edhe burgje te tjere.

Qellimi kryesor i punes se vullnetareve eshte lehtesimi i qendrimit ne keto ambjente te te burgosurve. Vullnetaret bisedojne dhe diskutojne me ta rreth tematikave te ndryshme.

Grupi i vullnetareve perpos punes se tyre ne qendrat e siper permendura kane zhvilluar edhe shume aktivite ne bashkpunim me sektorin social te Caritas Shqiptar.

- Ne trajnimet qe zhvillohen formatoret here pas here marrin me vete disa vullnetareve. Keta vullnetare ne keto formime marrin pjese per te deshmuar eksperiencen e vete ne animacion dhe pune vullnetare, gjithashtu eshte nje mundesi shume e mire per te dhene modelin e tyre te organizimit ne qendra te ndryshme.
- Ne periudhen e veres qendrat e Caritas-it zhvillojne shume aktivite animuese me te rinjte dhe femijet. Shume nga qendrat kane pak mundesi per zhvillimin e ketyre aktiviteve per arsye te ndryshme: materiale, te ambjenteve dhe humane.

Ekipi i formimit se bashku me pergjegjesin e grupit te vullnetareve, do te pregatitin nje kalendar per asistencen ne kampet verore ne qendra te ndryshme te Caritas-it .

Vullnetaret e Caritas-it Shqiptar jane te motivuar dhe te gatshem per te ndihmuar ne pune nga me te ndryshmet qe i kerkohen nga pergjegjesit e Caritas-it

PROJEKTI RAJONAL PSM

Qëllimi: Caritas-i në shenjë të solidaritetit, promovon punën e Caritas-eve të famullive dhe vlerat e vullnetarizmit të krishterë në rajonin e Europës Juglindore.

Ky projekt bashkpunimi rajonal ne muajin Janar 2009 eshte perqendruar me shume ne percaktimin e datave te aktiviteteve te ndryshme qe do zhvillohen gjate vitit 2009.

Caritas-i Shqiptar do te jete organizatori i Takimit vjetor te Drejtoreve te Caritas-eve te Rajonit i cili do te zhvillohet ne 27-28 Maj ne Shkup.

Ky takim do te vleresoje punen e zhvilluar nga ky projekt ne te gjithe Caritas-et si dhe planifikimin per aktivitetet vitin qe vjen.

Ne kete takim te Drejtoreve te Caritas-eve te Rajonit, Drejtori i Caritas Shqiptar do te paraqese gjithashtu edhe iniciativen per ngritjen e “Observatorit te Varferise” ne Shqiperi si nje model qe mund te aplikohet edhe nga Caritas-et e tjera.

Ky projekt mbeshtetet nga CRS dhe Caritas Italian.